



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR
FORMËN, LLOGARITJEN DHE SHUMËN E FONDEVE TË VETA QË DUHET TË
KETË DETYRIMISHT SHOQËRIA ADMINISTRUESE E FONDEVE**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 132, datë 30.09.2020

**NENI 1
OBJEKTI I RREGULLORES**

Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i formës, llogaritjes dhe shumës së fondeve të veta që duhet të ketë detyrimisht dhe në çdo kohë shoqëria administruese e fondeve.

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Kjo rregullore hartohet në përputhje me nenin 13, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

**NENI 3
PËRKUFIZIMET**

Të gjitha përkufizimet e kësaj rregulloreje janë të njëjta me ato të Ligjit për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive të referuar në këtë rregullore si “Ligji”.

NENI 4
FONDET E VETA TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE

1. Fondet e veta të shoqërisë administruese të fondeve, në çdo kohë, duhet të jenë të paktën në vlerën 15,800,000 (pesëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë.
2. Nëse totali i aktiveve nën administrim nga shoqëria administruese, tejkalon shumë prej 31,600,000,000 (tridhjetë e një miliardë e gjashtëqind milionë) lekë, fondet e veta të shoqërisë i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni zmadhohet me 0.02 për qind të shtesës së vlerës së aktiveve nën administrim nga shoqëria administruese mbi kufirin e përmendur në këtë pikë deri në maksimumin prej 1,300,000,000 (një miliard e treqind milionë) lekë.
3. Pavarësisht sa është parashikuar në këtë nen, fondet e veta të shoqërisë administruese nuk duhet të jenë më pak se 1/4 e shpenzimeve fikse të shoqërisë administruese të llogaritura, bazuar në pasqyrat financiare të vitit paraardhës.
4. Fondet e veta të shoqërisë administruese, në çdo kohë, duhet të jenë jo më pak se:
 - a. Vlera e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni; dhe
 - b. Vlera e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

Në kuptim të shkronjës “a”, të kësaj pike, përjashtohen portofolat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, që shoqëria i administron në formë të deleguar.

5. Nëse shoqëria administruese fillon veprimtarinë gjatë vitit kalendarik, fondet e veta duhet të jenë në çdo moment:
 - a. Jo më pak se vlera e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni; dhe
 - b. Jo më pak se 1/4 e shpenzimeve fikse të shoqërisë të parashikuara në planin e biznesit.
6. Përcaktimi i kërkesës për fondet e veta, sipas pikës 4, të këtij neni, që e tejkalon kërkesën për kapital të shlyer, sipas pikës 2, të këtij neni, mund të mos përmbushet deri në 50 % të kërkesës për fonde të veta nëse ato përfitojnë një garanci të së njëjtës shumë, të lëshuar nga një bankë ose shoqëri sigurimesh.
7. Shoqëria administruese njofton menjëherë Autoritetin, nëse fondet e veta bien nën nivelin e kërkuar në këtë rregullore.
8. Nëse fondet e veta të shoqërisë bien nën nivelin e përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, atëherë Autoriteti zbaton masat mbikëqyrëse në përputhje me Ligjin.

NENI 5

SHPENZIMET FIKSE

1. Shpenzime fikse konsiderohen shpenzimet që janë të pavarura nga aktivet nën administrim dhe nga rezultati i shoqërisë administruese, të tilla si:
 - a. Shpenzimet për personelin;
 - b. Shpenzime të tjera fikse;
 - c. Amortizimi i aktiveve materiale afatgjata;
 - d. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe;
 - e. Rregullimi i vlerës së aktiveve afatshkurtra.
2. Në zbatim të këtij neni, pjesa e shpenzimeve të personelit që varen ekskluzivisht nga rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë administruese dhe që parashikohen ligjërisht (nëpërmjet kontratës) janë të zbritshme nga shkronja a) pika 1 e këtij neni.
3. Shpenzimet e jashtëzakonshme nuk konsiderohen shpenzime fikse sipas parashikimit të pikës 1 të këtij neni.

NENI 6

FONDET E VETA

1. Fondet e veta përbëhen nga:
 - a. Kapitali i nënshkruar dhe i shlyer;
 - b. Rezerva të kapitalit;
 - c. Rezerva e rivlerësimit;
 - d. Rezerva të tjera;
 - e. Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme;
 - f. Fitimi ushtrimor i fundit të vitit;
 - g. Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese.
2. Duke zbritur:
 - a. Humbjet e vitit aktual që nuk janë përfshirë në të ardhurat e deklaruara apo rezervat e kapitalit;
 - b. Aktive afatgjata materiale;
 - c. Aktive jo-materiale;
 - d. Llogari të arkëtueshme tregtare;
 - e. Shpenzime të parapaguara;
 - f. Aktivet që nuk hyjnë në kategorinë e përcaktuar si aktive të vlefshme.

3. Aktivët e vlefshme:

- a. Mjete monetare dhe depozita bankare me kushtin që të mos tejkalohet 20% e vlerës së kapitalit (që përfshin të gjitha gjerat e pikës 1 të këtij neni) në një bankë;
- b. Tituj Borxhi të Shteteve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe/ose vendeve anëtare të OECD-së, me vlerësim të kreditit të paktën BBB-;
- c. Tituj borxhi të emetuara dhe/ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- d. Tituj Borxhi të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në monedhën lokale.

NENI 7

FONDET E VETA TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE E CILA ADMINISTRON EDHE FONDE PENSIONI VULLNETAR

Në llogaritjen e fondeve të veta për një shoqëri administruese të fondeve e cila administron edhe fonde pensioni vullnetar do të merren në konsideratë kërkesat më shtrënguese në lidhje me aktivët e vlefshme midis kësaj rregulloreje dhe rregullores nr. 1, datë 28.01.2010 "Për aktivët e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit", ndryshuar.

NENI 8

VLERA E AKTIVEVE TË ADMINISTRUARA NGA SHOQËRIA ADMINISTRUESE E FONDEVE

1. Shoqëria administruese e fondeve për efekt të llogaritjes së totalit të aktiveve nën administrim të përmendura në paragrafin 2 të nenit 4, të kësaj rregulloreje, merr në konsideratë:
 - a. Totalin e aktiveve nën administrim të secilit prej fondeve të investimeve nën administrimin e shoqërisë administruese të fondeve duke përfshirë aktivët, për të cilat është deleguar funksioni administrues por duke përjashtuar aktivët që ajo administron si rezultat i delegimit nga një shoqëri tjetër;
 - b. Totalin e aktiveve nën administrim të secilës prej shoqërive të investimit, portofoli i të cilave, administrohet nga shoqëria administruese e fondeve;
 - c. Totalin e aktiveve nën administrim të fondeve të pensionit vullnetar nën

administrimin e shoqërisë administruese të fondeve duke përfshirë aktivet për të cilat është deleguar funksioni administrues, por duke përjashtuar aktivet që ajo administron si rezultat i delegimit nga një shoqëri tjetër.

NENI 9 SHKELJET

Mosrespektimi i dispozitave të kësaj rregulloreje përbën shkelje dhe shoqëria administruese e fondeve do të jetë subjekt i masave mbikëqyrëse të parashikuara në Ligj.

NENI 10 SHFUQIZIMI

Rregullorja nr. 96, datë 05.06.2014 “Për formën, llogaritjen dhe shumën e kapitalit që duhet të ketë detyrimisht shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, e ndryshuar, shfuqizohet.

NENI 11 DISPOZITA KALIMTARE

Shoqëritë administruese të fondeve të licencuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje duhet të marrin masat e nevojshme që të përshtatin veprimtarinë me kërkesat e kësaj rregulloreje brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

NENI 12 HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.